




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK	Nr Prot 03-02/4024/1
Dep. DPK	Br Prot Prot No
Nr. i Tag	Data 07-12-2017
Broj. stranica 02	Date
Nr. pages	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2440/17, për zyrtarin e lartë z. Zaim Gashi, Drejtor i Klinikës së Gastroenterologjisë - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2440/17, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Zaim Gashi, Drejtor i Klinikës së Gastroenterologjisë - Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Zaim Gashi, figuron si person i autorizuar në biznesin privatë me emër O.P.S. "Gastro" e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr. 04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Gashi, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe ka shprehë interes për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.

Lidhur me këtë çështje është organizuar një takim në zyrat e AKK-së, me zyrtarin z.Zaim Gashi, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me rastin e iniciuar.

z.Gashi, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se nuk ka qenë i informuar, pasi që ky biznes nuk zhvillon aktivitet por ka mbet vetëm i regjistruar në ARBK-ë,por ka deklaruar se do të veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjell dëshmi se nuk do të figuroj si person i autorizuar ne këtë biznes.

Pas këtyre veprimeve, nga z.Zaim Gashi, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë Zaim Gashi, nuk figuron me si person i autorizuar ne biznesin e tij privat me emër O.P.S. "Gastro".

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z.Zaim Gashi, Drejtor i Klinikës së Gastroenterologjisë - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, duke bërë ndryshimet në biznes, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar ne biznesin e tij privat janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

